

Mike Pompeo në Fanari-takohet me Patriarkun Ekumenik Vartholomaío



Sekretari amerikan i shtetit Mike Pompeo, ndodhet në Konstantinoúpoli nga e Hëna në pasdite, pas vizitës në Paris, në kuadrin e turneut të tij në shtatë vende të Evropës dhe Lindjes së Mesme.

Sekretari amerikan i Shtetit mbërritii në Fanari të martën në mëngjes, ku u takua me Patriarkun Ekumenik Vartholomaío për të diskutuar së bashku çështjet fetare në Turqi dhe rajon, por dhe të promovojë «angazhimin e fortë të SHBA-së për lirinë fetare në të gjithë botën».

Gjithashtu përmendim se z. Pompeo nuk do të takohet me zyrtarë turq por vetëm me Patriarkun Ekumenik z. Vartholomaío.

Më parë në Paris, zyrtari amerikan kishte bisedime me presidentin francez Emmanuel Macron.

Mike Pompeo në një intervistë me gazetën franceze Le Figaro, tha se «Macron dhe unë kaluam shumë orë duke diskutuar për veprimet e fundit të Turqisë dhe

theksuam se ato janë shumë agresive».

Në vazhdim theksoi se «Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të bashkëpunojnë për të bindur Erdoğanin se veprime të tilla nuk janë në interes të popullit të tij».

— ert.gr